

## AKTI I THEMELIMIT TE SHOQERISE

**“BREEZ BAY” Shpk**

Sot më date 17 / 02 / 2023, unë i nënshkruari:

**z.Mozak Xhelili**, i datëlindjes 14.05.1983, lindur ne Sarande ,Shqipëri dhe banues në Tirane, shpreh vullnetin për hartimin e këtij Akti Themelimi të Shoqërisë “**BREEZ BAY** ” sh.p.k. si më poshtë vijon:

### **1. Forma ligjore e shoqërisë**

Shoqëria “**BREEZ BAY** ” shpk, nga këtu e mëposhtë në këtë akt, e referuar si shoqëria, themelohet si një shoqëri tregtare në formën e “Shoqërisë me Përgjegjësi të kufizuar”, shkurtimisht SHPK.

### **2. Ortaku i vetëm themelues**

Ortaku i vetëm themelues i shoqërisë është **z.Mozak Xhelili**.

### **3. Objekti i veprimtarisë**

Objekti i aktivitetit të shoqërisë “**BREEZ BAY** ” sh.p.k. do të jetë:

- Punime suvatimi,armature ,hekurkthyes,pllaka,murature,parket,hidrosanitare,elektrike.
- Punime ne ndërtim në objekte të ndryshme ndertimi,godina banimi dhe sherbimi,resorte turistike,rruge,kanalizime,ujesjellsa,vepra arti,diga,mbrojtje kundër zjarrit.Investim ne ndërtim. Dhenie me qera te ambienteve.
- Import – eksport mallra industrial,ushqimor,bimesh medicinale farmaceutike,fruta perime.
- Shitje me shumice dhe pakice te materialeve te ndertimit,artikuj industrial,ushqimore,mobileri,pasticeri,kancelari ,elektroshtepiake.

### **4. Selia e shoqërisë**

4.1 Selia e Shoqërisë “BREEZ BAY ” sh.p.k. do të jetë në Sarande, në adresën: rr Idriz Alidhima ,godine private nr 4 ,zk 8641 nr pasurie 5/294 .

4.2 Shoqëria mund të vendosë të hapë degë, filiale apo zyra përfaqësie në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe jashtë saj.

### **5. Kohëzgjatja e shoqërisë**



Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj, sipas objektit, për një periudhë 20 (njezet) vjeçare, e cila fillon nga data e regjistrimit të saj në regjistrin tregtar.

Afati i përmendur në pikën 1 të këtij nen mund të shkurtohet apo zgjatet me vendim të ortakut të vetëm, në përputhje me rregullat e përcaktuara nga ky Statut.

## 6. Kapitali i shoqërisë

Kapitali themeltar i shoqërisë tregtare “**BREEZ BAY**” sh.p.k. është 10.000.000 (dhjete milion ) Lekë.

E gjithë pjesa e kapitalit themeltar është nënshkruar në tërësinë e saj nga Ortaku themelues.

Kapitali themeltar mund të zmadhohet edhe me kontribute në natyrë.

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit themelor të **Shoqërisë** bëhet me vendim të **Ortakut të vetëm**. Fondi në të holla që vjen nga shlyerja e pjesëve të kapitalit themeltar depozitohet për llogari të **Shoqërisë** në të gjitha Bankat që ndodhen në territorin e Shqipërisë.

Transferimi i pjesëve të kapitalit themeltar bëhet me akt notarial.

## 7. Ortaku i vetëm

Ortaku i Vetëm ushtron kompetencat që ligji i jep Asamblesë së Otakëve.

## 8. Drejtimi dhe Administrimi

Shoqëria drejtohet nga Administratori.

Administratori i parë i shoqërisë “**BREEZ BAY**” sh.p.k. është z.Mozak Xhelili. Administratori emërohet me vendim të Ortakut të vetëm, për një periudhë jo më shumë se 5 vjet. Përfaqësimi i shoqërisë tregtare “**BREEZ BAY**” sh.p.k. në marrëdhënie me të tretët dhe brenda kufijve që i njeh ligji dhe Statuti, i përket Administratorit të saj. Ai ka të drejtë të përfaqësojë Shoqerinë edhe në organet gjyqësore apo të ngarkojnë për këtë qëllim një zyrë avokatie në mbrojtje të interesave të Shoqërisë.

## 9. Shpërbërja dhe likuidimi

Shpërbërja dhe likuidimi i shoqërisë tregtare mund të vijë në çdo kohë dhe për çfarëdo shkaku ligjor, duke përfshirë dhe falimentimin, privimin për të ushtruar profesion tregtar, forca madhore, rast lufte dhe të çdo faktori tjeter që nuk varet nga vullneti i ortakëve të shoqërisë.

**Themeluesi**

**Mozak Xhelili**

